

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 3, neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10 dhe nenin 41 paragrafi (6) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 42 paragrafi (2) nga Ligji i njëjtë, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 3 dhe nenin 41 paragrafi (1) nënparagrafi 8 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ark.nr.01-3632/1 datë 22.8.2025 dhe Njoftimi për ndryshimin e strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO VAT SHPK Shkup PA1 nr.02-364 datë 30.12.2025, në pajtim me Konkluzionin e Këshillit ark.nr.02-174/5 datë 14.1.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 1-rë të mbajtur më 14.1.2026, miratoi si vijon:

VENDIM

1. LEJOHET ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO VAT SHPK Shkup, përkatësisht:

- për heqjen e personit fizik Ekrem Kadri, me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në [REDAKTUAR], me pjesëmarrje prej 50% në kapitalin bazë dhe të personit fizik Mefail Kadri, me [REDAKTUAR] dhe adresë në [REDAKTUAR] me pjesëmarrje prej 50% në kapitalin bazë; dhe

- për hyrjen e personit juridik BASHKËSIA FETARE ISLAME e Republikës së Maqedonisë së Veriut Shkup, me NVAS 4069676 dhe adresë në rr."Çairska" nr.52 Çair, Shkup.

2. Detyrohet Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO VAT SHPK Shkup, pas ndryshimit të kryer, paraqitur në pikën 1 të këtij Vendimi, drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele t'i dorëzoj gjendjen aktuale vijuese të dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO VAT SHPK, detyrohet të zbaton ndryshimin në strukturën e pronësisë nga pika 1 e këtij Vendimi në Regjistrin Qendror të RMV-së, në afat prej 90 ditësh nga dita e miratimit të këtij Vendimi. Nëse ndryshimi nuk zbatohet në afatin e caktuar, ky Vendim do të anulohet.

4. Ky vendim hyn në fuqi me ditën e miratimit.

Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO VAT SHPK Shkup, në pajtim me nenin 41 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.171/14), me Njoftim për ndryshimin e strukturës së pronësisë (PA1 nr.02-364 datë 30.12.2025), ka njoftuar Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) për qëllimin e zbatimit të ndryshimit në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO VAT SHPK Shkup.

Njoftimi i dorëzuar për ndryshimin e strukturës së pronësisë (PA1 nr.02-364 datë 30.12.2025) nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO VAT SHPK Shkup u përcaktua se është i kompletuar dhe i rregullt, përkatësisht i përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentet e përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë.

Agjencia, me qëllim që të hetojë nëse ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO VAT SHPK Shkup do të krijojnë koncentrim të paligjshëm mediatik, përkatësisht nëse janë në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 të LSHMAAV, përmes Sistemit të Shpërndarjes së Internetit të Regjistrin Qendror të RMV-së, siguroj Informacion mbi lidhjen me subjekte (persona të autorizuar, organe drejtuese, pronarë në subjekte të tjera) - gjendja aktuale, nr. 0820-50/150020250498434 datë 31.12.2025, nr.0820-50/150020260005797, nr.0820-50/150020260005833, nr.0820-50/150020260005862, nr.0820-50/150020260005868, nr.0820-50/150020260005897, nr.0820-50/150020260005910 dhe nr.0820-50/150020260005925 të gjitha me datë

12.1.2026 nga ku shihet qartë se personi juridik BASHKËSIA FETARE ISLAME e Republikës së Maqedonisë së Veriut Shkup, figuron si themelues/pronar i Agjencisë Turistike DARUSSELAM – IVZ SHPKNJP Shkup, me veprimtari/kodi kryesor i të ardhurave është 79.11 – Veprimtari të agjencive turistike; Shoqatë për qëllime humanitare HILAL – Shkup, me veprimtari/kodi kryesor i të ardhurave është 94.99 – Veprimtari në organizata të tjera në bazë anëtarësimi, të papërmendura diku tjetër (në dokumentin nga Regjistri Qendror nuk ka informacion në lidhje me rolin e Bashkësisë Fetare Islame në këtë shoqatë); si themelues/pronar i Shoqatës së Shërbimeve Funerale ER-RAHATÛ SHPKNJP Shkup veprimtari me prioritet/kodi kryesor i të ardhurave është 96.300 – Veprimtari funerale dhe veprimtari të ngjashme; në FAKULTETIN E SHKENCAVE ISLAME Shkup veprimtari me prioritet/kodi kryesor i të ardhurave është 85.400 – Arsimi i lartë (në dokumentin nga Regjistri Qendror nuk ka informacion në lidhje me rolin e Bashkësisë Fetare Islame në fakultet); si themelues/pronar i Organizatës Humanitare HILAL IVZ – Shkup, aktivitet prioritar/kodi kryesor i të ardhurave është 94.990 – Veprimtari në organizata të tjera bazuar në anëtarësim, të papërmendura diku tjetër; dhe si themelues/pronar i Shkollës së Mesme MEDRESEJA ISA BEU – Shkup Shkolla për arsim të mesëm MEDRESEJA ISA BEU – Shkolla, aktivitet prioritar/kodi kryesor i të ardhurave është 85.310 – Arsimi i mesëm i përgjithshëm. Personat juridikë Agjencia Turistike DARUSSELAM – IVZ SHPKNJP Shkup, Shoqata për Qëllime Humanitare HILAL – Shkup, Shoqata e Shërbimeve Funerale ER-RAHATU SHPKNJP Shkup, FAKULTETI I SHKENCAVE ISLAME Shkup, Organizata për Qëllime Humanitare HILAL IVZ – Shkup dhe Shkolla e Mesme MEDRESEJA ISA BEU – Shkup, nuk figurojnë si themelues të shoqërive tregtare.

Personi fizik Shaqir Fetai figuron si personi i autorizuar i BASHKËSISË FETARE ISLAME të Republikës së Maqedonisë së Veriut Shkup, aktiviteti prioritar/kodi kryesor i të ardhurave është 94.91 – Veprimtari të organizatave fetare. Të dhënat për këtë person juridik janë paraqitur më sipër.

Përveç kësaj, Agjencia ka kryer kontroll në Regjistrin e pronarëve përfitues të mbajtur nga Regjistri Qendror i RMV-së, nga ku siguroi dokumentin Gjendja aktuale për personin fizik - pronar përfitues, nr.2007-50/150020250498451 datë 31.12.2025, për Shaqir Fetai, nga ku mund të konstatohet se ky person është evidentuar si pronar i vetëm në regjistrin e pronarëve përfitues të BASHKËSISË FETARE ISLAME në Republikën e Maqedonisë Shkup, Shoqërisë së Shërbimeve Funerale ER-RAHATÛ SHPKNJP Shkup dhe FAKULTETI I SHKENCAVE ISLAME Shkup.

Pas ndryshimit të kryer në strukturën e pronësisë, pronar i vetëm i Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO TVSH SHPK Shkup do të jetë personi juridik BASHKËSIA FETARE ISLAME e Republikës së Maqedonisë së Veriut Shkup, me NVAS 4069676 dhe adresë në rr. "Çairska" nr.52 Çair, Shkup.

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO VAT SHPK Shkup është e detyruar ta zbatojë ndryshimin në strukturën e pronësisë nga pika 1 e këtij Vendimi në Regjistrin Qendror të RMV-së, në afat prej 90 ditësh nga data e miratimit të këtij Vendimi. Nëse ndryshimi nuk zbatohet në afatin e caktuar, ky Vendim do të anulohet.

Duke pasur parasysh se Agjencia konstatoi se me zbatimin e ndryshimit në strukturën e pronësisë së Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO VAT SHPK Shkup nuk krijon përqendrim të paligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, përkatësisht se ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat në nenet 34, 35 paragrafi (2) ose 38 nga Ligji i njëjtë, pas Njoftimit të dorëzuar për ndryshimin në strukturën e pronësisë së Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO VAT SHPK Shkup PA1 nr.02-364 datë 30.12.2025, Këshilli i Agjencisë miratoi vendim si në dispozitiv.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi transmetuesi, nëse është i pakënaqur me vendimin, ka të drejtë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit të paraqesë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente.